



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET PËRFITUESE
QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI
URBAN I ZONËS PERSPEKTIVE TID, ME VENDNDODHJE NË PARKUN
ARKEOLOGJIK Durrës”**

Të nderuar këshilltarë !

Bashkia Durrës ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi midis Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Albanian – American Development Foundation (AADF), në të cilën ministria është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, ruajtjen dhe administrimin e pasurisë kulturore. Gjithashtu në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sipërcituara protokolluar me tonën nr.7773/1 prot., datë 02.10.2023, AADF angazhohet që të financojë ndërhyrjet në infrastrukturë në zonën TID si dhe modelin e administrimit/menaxhimit të zonës TID Durrës. Theksojmë që zona në të cilën do të zbatohet ky projekt është një pjesë e rëndësishme e pasurisë kombëtare e arkeologjike jo vetëm e një individi, por e gjithë qytetit dhe mbarë vendit. Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit është vijuar nga ana jonë me procedurat e shpronësimit në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar. Shpronësimi për interes publik bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i sanksionuar në nenin 41 si dhe në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera në nenin 8 përcaktohet se: “Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për këto shkaqe: “ ... Për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut...”. Pas përfundimit të procedurave u hartua relacioni për shqyrtim në Këshillin Bashkiak, i cili vendosi vlerësimin paraprak të pasurive, pronë private që preken nga ky investim me Vendimin nr. 32, datë 23.06.2025 “Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024, “Për miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”. Ky vendim u përcoll pranë ASHSH-së e cila ka

kompetencën ligjore për të kryer vlerësimin përfundimtar të vlerës së shpronësimit, nga ku rezulton dhe vendimmarrja e Këshillit të Ministrave me miratimin e Vendimit nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”.

Konkretisht, Projekti përfshin:

- ✓ Shpronësim 74 objekte, sipas Vendimit nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”, me vlerë 315,524,013.82 lekë.
- ✓ Shpronësimin e 10 pasurive sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës”..

Në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga këto akte, Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit ka kryer njoftimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, për prishjen e këtyre objekteve që janë pjesë e projektit TID. Zbatimi i projektit TID, si investim strategjik për zhvillim urban të qytetit ka sjellë zhvendosje të detyruar të një numri familjesh, banorë në njësinë administrative nr.1, të cilët kanë pasur banesën e tyre të vetme brenda kufirit të projektit. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve këto familje, ndonëse subjekte shproësimi ose jo, nuk kanë përfituar ende pagesën e kompensimit financiar të shpronësimit për shkak të procedurave administrative dhe financiare në proces.

Bashkia Durrës paraqet para Jush këtë relacion mbi listën e familjeve të cilat ndodhen në kushtet emergjente për strehim, duke qenë se banesat e tyre prishen për shkak të ndërtimeve të veprave për interes publik, dhe propozojmë që deri në momentin e kompensimit financiar të shpronësimit, këto familje të subvencionohen si familje përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura përkohësisht të pastreha si pasojë e restaurimit dhe rikualifikimit urban të zonës perspektive TID.

Familjet përfituese të subvencionimit të qirasë janë pronarë të banesave që kufizohen nga Projekti TID, në Zonën Kadastrale 8512 dhe 8514.

Sqarojmë se për vijimin e procedurave të shpronësimit, jeni shprehur dhe Ju për listat emërore të familjeve që shpronësohen, me vendimet si më poshtë :

- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024, “Për miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”.

- Vendimin nr. 32, datë 23.06.2025 “Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024, “Për miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”.

Familjet, që janë subjekte shpronësimi në kuadër të Projektit TID, bazuar në legjislacionin në fushën e strehimit, duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, duke paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

- certifikatë familjare e aplikantit;
- vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku banesa që shpronësohet është vendbanimi i zakonshëm.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar:

- vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ish zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Durrës) për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
- vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjestar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese.(origjinale)

c) Kanë liruar ose janë në proces lirimi të banesës;

d) Kontratën e qirasë.

Kohëzgjatja e subvencionimit të qirasë do të zgjasë deri në likuidimin e plotë të kompensimit financiar të shpronësimit, por jo më shumë se një vit. Si referencë për llogaritjen e masës së subvencionimit të qirasë është marrë VKB nr.41, datë 21.05.2024 “ Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, ku është miratuar vlera e pagesës së qirasë sipas tregut të lirë për struktura përkatëse të apartamenteve, si më poshtë:

- Qiraja për strukturën e apartamentit për 1+1, është 30 000 (tridhjetëmijë) lekë/muaj.
- Qiraja për strukturën e apartamentit për 2+1, është 35 000 (tridhjetepesëmijë) lekë/muaj.
- Qiraja për strukturën e apartamentit për 3+1, është 40 000 (dyzetëmijë) lekë/muaj.

Pas vlerësimit të dokumentacionit, Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Shërbimit Social merr masat e menjëhershme të bashkëpunojë me njësinë administrative e cila do të bëjnë njoftimet për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Efeket financiare për subvencionin e qirasë do të përballohen nga fondet e buxhetit të Bashkisë Durrës.

Ky relacion ka për qëllim të zgjidhë problemin e strehimit të përkohshëm pa vonesë dhe përmes mjeteve juridike civile dhe administrative.

Duke Ju falenderuar, mbetemi të sigurtë në bashkëpunimin tuaj.

DREJTORIA JURIDIKE

Drejtör
Alneida Rroshi

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtör
Diola Xhango